



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## ***BULETINI DITOR I FSSHM-së***

***PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E  
SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE  
MEDIUMET ELEKTRONIKE***

***12 - 14 Dhjetor 2015***



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: info@fzo.org.mk



## Pas stomatologëve, në rradhë mjekët amë, kapitacioni nga 50 në 55 denarë



Pas rritjes së kapitacionit për stomatologët amë, Ministri i shëndetësisë, Nikolla Todorov, paralajmëroi sot rritjen e kapitacionit edhe për mjekët amë. Sipas këtyre ndryshimeve, mjekët amë, në vend që të marrin 50 denarë, do të marrin nga 55 denarë për pacientë.

„Nëse keni 1.000 pacientë, kjo do të thotë 5.000 denarë për muaj. Nëse keni 2.000 pacientë, në këtë rast do të keni 10 mijë denarë shtesë për muaj”, tha Todorov.

Edhe pse një pjesë e mjekëve këtë rritje e kanë komentuar si fushatë parazgjedhore, sipas ministrit, ky është përdorimi

racional i mjeteve të sistemit shëndetësor.

„Kjo nuk është fushatë parazgjedhore, por është përdorimi racional i mjeteve të sistemit shëndetësor. Duhet pasur parasysh se këtë vit kemi rritje të buxhetit të fondit për rreth 22 milionë euro. Këtë masë e publikojmë tani, sepse buxheti për vitin e ardhshëm miratohet një vit më parë”, shtoi ai.

Sipas specialistit të mjekësisë dhe pronarit të institucionit shëndetësor “Medikus 92”, Jovan Gurev, kjo rritje është e vogël dhe simbolike.

„Nevojiten të paktën 20 për qind për të rritur kapitacioni. Nëse është vetëm për 5 denarë, atëherë do të jetë më mirë që të mos ketë rritje, sepse ne jemi njerëz me dinjitet. Kjo rritje për 10 për qind nuk është rritje, të jetë ose të mos jetë, njëlloj është. Në qoftë se rritja është kaq, atëherë paratë e mia le të shkojnë në qëllime bamirëse”, tha Gurev.

Vetëm javën e kaluar ishin publikuar disa masa të reja në shëndetësi, siç është rritja e kapitacionit të stomatologëve amë, zgjerimi i listës pozitive të barnave, lëshimi në funksion pajisjet e reja për terapi fizikale në Poliklinikën “Bukuresht”, lëshimi në përdorim i tomografit kompjuterik për pacientët që pësojnë sulme në tru, siç dhe masa e re që mundëson kthimin e specialistëve dhe infermiereve nga sektori privat shëndetësor në ate publik.

## Përkundër kundërshtimeve të ministrisë, klinika në Kozle flet edhe Shqip (VIDEO)



Edhe pse nga Ministria e Shëndetësisë kundërshtuan, mbishkrimi në Spitalin Special për sëmundjen e mushkërive tek fëmijët në Kozle, do të jetë edhe në gjuhën shqipe. Këtë e siguron drejtori i këtij institucioni

www.fzo.org.mk



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



Rijad Alimi. Në hyrje të këtij objekti nuk mund të vërehej ndonjë tabelë që tregon se për çfarë institucioni bëhet fjalë.

Drejtori Alimi thotë se tabela fillimisht ishte vetëm në gjuhën maqedonase, por pas insistimit të tij, tabela është kthyer për tu shtuar edhe gjuha shqipe, dhe e njëjta do të vendoset javën e ardhshme.

“Siç mund ta shihni edhe brenda, dy gjuhësia është zbatuar në përgjithësi, në të gjitha dhomat dhe në të gjitha vendet tjera. Mbishkrimi i spitalit pak u anulua, me qëllim që të bëhet në dy gjuhë, dhe besoj që deri të enjten ose të premten do të realizohet edhe ajo punë, do të thotë mbishkrimi do të vendoset mbi spitalin”, tha Alimi.

Mbishkrimet në dy gjuhë vëreheshin edhe brenda spitalit, kurse drejtori i këtij institucioni edhe fjalimin e hapjes e mbajti në gjuhën shqipe.

“Të nderuar, më lejoni që edhe një herë të shpreh kënaqësinë time që ky vend vital për sëmundjen e fëmijëve tonë, të jetë vend i shenjtë, dhe kam kënaqësinë të jem pjesë e menaxhmentit të këtij spitali. Ju faleminderit”, shtoi ai.

Në hapjen solemne ishin prezent edhe kryeministri Nikolla Gruevski dhe Ministri i Shëndetësisë, Nikolla Todorovo. Kryeministri Gruevski tha se qeveria po vazhdon me modernizimin e sistemit shëndetësor në Maqedoni. I gjithë projekti ka kushtuar 8 milion euro, kurse shtrihet në një hapësirë prej 6.500 metra katrorë.

## Maqedoni: Për 6 vjet, 16 gra humbin jetën si pasojë e dhunës në familje



Përfaqësuesit e organizatave joqeveritare thonë se janë alarmante të dhënat e hulumtimeve të realizuara nga sektori civil për viktimat e dhunës. Sipas këtyre të dhënave, çdo e treta grua në Maqedoni është viktimë e dhunës, qoftë ku bëhet fjalë për dhunën fizike, qoftë për atë psikike.

**Xhane Kreshova** nga Forumi i Gruas në Tetovë konsideron se dhuna ndaj grave duhet trajtuar si çështje që kërkon seriozitet të theksuar, sepse siç nënvizon zonja Kreshova, pavarësisht një morie ligjesh, të miratuara që garantojnë drejtësinë sociale për gratë, shumë nga to ende janë viktimë e dhunës familjare apo

seksuale.

*“Edhe pse në Maqedoni janë miratuar një mori ligjesh për mbrojtjen e të drejtave të grave, madje Qeveria ka miratuar programe të ndryshme – të gjitha këto nuk mjaftojnë ose do të thosha nuk janë aq sa duhet efektive, sepse të njëjtat nuk funksionojnë në praktikë. Ne, si OJQ që merremi me problematikën e dhunës, vite me radhë organizojmë tribuna të ndryshme me qytetarët në shumë qytete. Por, kjo nuk mjafton, sepse duhet një strategji gjithëpërfshirëse e të gjitha organeve kompetente të shtetit për t’u luftuar me sukses kjo dukuri”.*

*“Dhuna ndaj grave në Maqedoni është e pranishme 37.7 për qind të numrit të përgjithshëm të popullatës së gjinisë femërore në Maqedoni. Kjo do të thotë se çdo e treta grua është viktimë e dhunës, qoftë ajo fizike, psikike, seksuale ose ekonomike dhe këto të dhëna tregojnë për atë se sa madhor është ky problem”, thekson ajo.*



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: info@fzo.org.mk



Organizatata joqeveritare në Maqedoni theksojnë se shumica e grave në Maqedoni, edhe në rastet kur ballafaqohen me dhunën dhe kanë mundësi ta denoncojnë, ato hezitojnë ta bëjnë një gjë të tillë se janë të frikësuar se nga rrethi shoqëror do të trajtohen jo si viktimë, po si femra që kanë dështuar në organizimin e familjes. Kjo bën që ato rrallëherë të marrin hapa ligjor kundër abuzuesve të tyre.

**Elena Dimshovska** nga rrjeti i organizatave për të drejtat e grave, thekson se problemi kryesor qëndron në sigurimin e provave, sepse në të shumtën e rasteve dhuna në familja ndodh pas dyerve të mbyllura.

*“Në nivel të shtetit, ka vetëm qendra nën ingerencat e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, të cilat kanë kapacitet për të strehuar jo më shumë se 30 gra njëkohësisht. Ato zakonisht kërkojnë ndihmë bashkë me fëmijët e tyre, në këtë rast çka mund të themi më shumë ku ajo primarja nuk mund të sigurohet, përkatësisht që ata të mund të qëndrojnë larg atyre që kanë ushtruar dhunë”,* thekson Dimshovska.

Si çështje shumë problematike, Kreshova fokuson mungesën e infrastrukturës sociale, veçanërisht në zonat rurale gjë që i bën gratë më të pambrojtura dhe njëkohësisht më të ekspozuara ndaj dhunës.

E para, sipas saj, është dhe mungesa e sigurisë materiale dhe mentalitetit shoqëror që favorizon gjininë mashkullore.

*“Këtu kemi të bëjmë dhe me varshmërinë ekonomike të gruas ndaj burrit, meqë s’ka ku të shkojë. Pasi të denoncojë dhunën sërish duhet të kthehet te dhunuesi. Për këtë arsye, shumica e grave detyrohen të durojnë dhunën dhe të mos e denoncojnë”.*

*“Dhuna nuk luftohet nëse mendon ‘hë për hë’ pra vetëm sot, por duhet të hartohen programe, fëmijët që nga moshat më të hershme të shkollimit të tyre t’i mësojmë për barazinë gjinore dhe të edukohen në frymën e barazisë me gratë, gjë që mungon në sistemin tonë edukativ- arsimor”,* shpjegon Kreshova.

Organizatata joqeveritare, të cilat në fokus kanë të drejtat e grave thonë se ndërjegjësimi i shoqërisë sa i përket dhunës në familje, është shumë i ulët, dhe kjo gjë, për fat të keq, bën që gishti i fajit nga pjesa më e madhe e shoqërisë akoma të drejtohet kah gruaja dhe jo nga pala që ka ushtruar dhunë.

E, të dhënat flasin se gjatë gjashtë viteve të fundit kanë humbur jetën 16 gra si rezultat i dhunës së ushtruar nga të afërmit e tyre.

## Familja Haliti nga Kumanova ka nevojë për ndihmë



Familja Haliti nga fshati Llopat i Kumanovës ka 20 vite që përballet me mungesën e një shtëpie dhe troket derë më derë për t’u strehuar. Momentalisht gjendet në një shtëpi pranë spitalit të qytetit, por të njejtën duhet ta lirojë në fund të muajit. Anëtarët e familjes kanë probleme shëndetësore, kurse nuk mund të mbulojnë shpenzimet mjekësore. Ata nuk kanë zgjidhje tjetër, apelojnë për ndihmë.

*“Kemi nevojë për një shtëpi, për një dhomë që ta dijme se është e jona.”*-deklaroi kryefamiljari **Adil Haliti**, *“Pronari i shtëpisë na ka thënë se mund të qëndrojmë këtu deri në Vitin e Ri, por nëse nuk mund të gjejmë ndonjë vend tjetër për të qëndruar, shpresojmë të na lejojë të qëndrojmë akoma... Nuk kemi ku të shkojmë!”*

42 vjeçari tregoi se dëshiron të punojë dhe se shkon sa herë që dikush i ofron punë, por se ka probleme serioze shëndetësore.

*“Burri është i sëmurë më se 10 vjet, ka probleme në tru dhe nuk sheh sa duhet. E ka gjendjen shumë të komplikuar dhe mjekët i kanë thënë se duhet të operohet nga specialist kompetent në Shkup e ndoshta do të ketë nevojë t’i vendosin ndonjë paisje në kokë. Shumë herë ka dalur për të punuar, por e kanë sjellur njerëzit në shtëpi, pasi e kanë gjetur në rrugë të alivanosur. Ka marrë shumë lëndime dhe ka filluar të ketë probleme psikike. Duhet të operohet patjetër, por nuk kemi mundësi t’i mbulojmë harxhimet e operacionit.”*-sqaroi



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: info@fzo.org.mk



## Razija.

*“Edhe vetë jam e sëmurë. Dy damarë të zemrës i kam të bllokuara. Mjekët më kanë thënë se duhet të më vendosin stendë, por ai kushtoka 100 euro! Po ku ti gjej unë ato 100 euro?! Nuk kam. Tani konsumoj barëra, por më kanë thënë mjekët se në rast se më bllokohet edhe damari i tretë më nuk do të mund të ngrihem në këmbë. Venat më kanë plasur në krahun e djathtë. Ndërsa këmbën e kam thyer, jam rrëzuar duke pastruar nëpër shtëpi të huaja. Kam pastruar kudo, për t’u siguruar pak ushqim fëmijëve. Në shkollë të katër janë. Një më vdiq, kam frikë për këto të tjerët. Por ka rreth 5 vite që më nuk mund të punoj edhe tensionin e gjakut lartë e kam çdo herë.”*

*“Vajza 4 muajshe fitoi ndeje në mushkëri e nuk pata mundësi ta dërgoja me kohë në mjek. Ditën kur e dërgova në spital më thanë se më nuk ka shpëtimit dhe se është tepër vonë. Duke u kthyer në shtëpi, më vdiq në duar. A ta qaj vajzën e vdekur apo këto të gjallët që nuk kanë as bukë për të ngrënë?! Duan edhe këta të shkojnë në shkollë si shoqet e shokët. Nuk i kanë kushtet. Të katër fëmijët janë të traumatizuar, pasi në shumë shtëpi ku kemi qëndruar nuk kemi pasur rrymë fare. Kur alivanoset burri, ata bërtasin nga frika se mos u vdesë i ati.”-rrëfeu 44 vjeçarja.*

Vajza e madhe **Mirsadja**, 14 vjeçare tha: *“Më ndihmojnë shoqet ndonjëherë, më japin fletore dhe ato fletore i ndaj me vëllezërit dhe motrën. Mundohem të mësoj, por në shkollë punojmë me kompjuter e unë nuk kam kompjuter.”* Sipas Razijes, Mirsadja dëshiron të rritet sa më shpejtë, të punojë, të ndërtojë shtëpi e ta dërgojë babanë në spital.

*“Djali 11 vjeçar, **Xhemaili** shkon në xhami dhe falet. Më thotë se e lut Zotin vetëm babanë ta ketë afër. Lutet të mos ia merr Zoti babanë ashtu siç ia mori motrën. Vajza tjetër, **Fiza** që nuk ka më se 9 vjet është e sëmurë nga zemra dhe çdo natë trembet në gjumë.”-vazhdoi Razija, “Asnjë prej fëmijëve nuk ka librezë shëndetësore e as që shfrytëzojmë ndihmë sociale.”*

Kjo gjendje e rëndë nuk e pengoi më të voglin, Idrizin 7 vjeçar të deklarojë dëshirën e tij, i buzëqeshur: *“Kur të rritem dua të bëhem berber. Kam dëshirë të pres flokë!”*

Numër kontakti: 071 872 927

## Tetova, Kumanova dhe Prilepi krysojnë me të sëmurë



Tetova, Kumanova dhe Prilepi janë qytetet të cilat rezultojnë të jenë me numër më të madh të të prekurve nga gripi. Sipas Institutit të Shëndetit Publik këtë sezon janë regjistruar 737 raste të të sëmurëve, nga të cilët 260 në Tetovë, 155 në Kumanovë, 129 në Prilep, ndërkaq nëpër qytetet e tjera rastet kanë qenë të rralla. Bekim Ismaili, specialist i mjekësisë

familjare në spitalin klinik të Tetovës është i bindur se gripi vjen si pasojë e ndryshimeve klimaterike.

*“Shkaqet janë tek ndryshimet klimatike, tash jemi në muajin dhjetor kur ka të reshur të borës të cilat do ta pastronin ajrin sadopak në përgjithësi, po ashtu e kemi edhe ndotjen e ajrit e cila është në regjionin e Tetovës dhe Shkupit më të theksuar. Ditëve të fundit kemi pasur edhe mjegull e cila ka qenë gjithë kohës në qytet, dhe konsideroj se këto janë shkaqet të cilat çojnë deri në rritjen e numrit të pacientëve të cilët i kaplon virusi sezonal”,* tha Bekim Ismaili, mjek.

Mjekët rekomandojnë që në rast të paraqitjes së mjegullës dhe ndotjes së ajrit mbi të lejuarën, të përdoren maska, ndërsa personat të cilët veç më janë të prekur nga gripi të mos qëndrojnë nëpër vende ku ka shumë njerëz ngase shanset për përhapjen e tij janë shumë të mëdha.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



“Nëse një njeri bën një kollitje apo teshtitje , me një veprim të tillë ai përhapë rreth një mijë viruse të cilat dinë të përhapen me të madhe në rrethin ku ka grumbullim më të madh të personave , prandaj dhe u rekomandojmë ata të cilët janë të sëmurë të mos rrinë afër të tjerëve”, u shpreh Bekim Ismaili.

Nga mesi i tetorit ka filluar vaksinimi kundër gripit . Sipas të dhënave, gjithsej janë vaksinuar 25.941 persona. Numri më i madh i të vaksinuarve janë të moshës mbi 64 vjeçare./Alsat-M



## Drejtori Alimi: Klinika në Kozle do të “flasë” edhe shqip

**Shkup, 13 dhjetor** - Përkundër kundërshtimit nga Ministria e Shëndetësisë, mbishkrimi në Spitalin Special për sëmundjen e mushkërive tek fëmijët në Kozle, do të jetë edhe në gjuhën shqipe. Këtë e siguron drejtori i këtij institucioni Rijad Alimi. Në hyrje të këtij objekti nuk mund të vërehej ndonjë tabelë që tregon se për çfarë institucioni bëhet fjalë.

Drejtori Alimi thotë se tabela fillimisht ishte vetëm në gjuhën maqedonase, por pas insistimit të tij, tabela është kthyer për tu shtuar edhe gjuha shqipe, dhe e njëjta do të vendoset javën e ardhshme.

“Siç mund ta shihni edhe brenda, dy gjuhësia është zbatuar në përgjithësi, në të gjitha dhomat dhe në të gjitha vendet tjera. Mbishkrimi i spitalit pak u anulua, me qëllim që të bëhet në dy gjuhë, dhe besoj që deri të enjten ose të premten do të realizohet edhe ajo punë, do të thotë mbishkrimi do të vendoset mbi spitalin”, tha Alimi.

Mbishkrimet në dy gjuhë vëreheshin edhe brenda spitalit, kurse drejtori i këtij institucioni edhe fjalimin e hapjes e mbajti në gjuhën shqipe.

“Të nderuar, më lejoni që edhe një herë të shpreh kënaqësinë time që ky vend vital për sëmundjen e fëmijëve tonë, të jetë vend i shenjtë, dhe kam kënaqësinë të jem pjesë e menaxhmentit të këtij spitali. Ju faleminderit”, shtoi ai.

Në hapjen solemne ishin prezent edhe kryeministri Nikolla Gruevski dhe Ministri i Shëndetësisë, Nikolla Todorovo. Kryeministri Gruevski tha se qeveria po vazhdon me modernizimin e sistemit shëndetësor në Maqedoni. I gjithë projekti ka kushtuar 8 milion euro, kurse shtrihet në një hapësirë prej 6.500 metra katrorë.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## U lëshua në përdorim Klinika e Fëmijëve – Kozle



Pas tre viteve punë intensive sot u lëshua në përdorim klinika për fëmijë Kozle...

Prej tani fëmijët me sëmundje të mushkërive dhe problem në frymëmarrje do të mjekohen dhe shërkohen në ndërtesën modern e cila i plotëson të gjitha kriteret në pajtueshmëri me standardet botërore.

Objekti ka kushtuar 8 milion euro ndërsa zë hapsirë prej 6.500 metër katrorë ndërsa është kompletuar me dhoma një dhe dy krevatëshe për nënëat dhe fëmijët, është e klimatizuar, me nyje sanitare në cdo hapsirë, korridore të gjëra. Deri tani ky insitut funksiononte në Baraka të ndërtuara pas termetit në Shkup.

## Oda stomatologjike e Maqedonisë simpozium për metoda dhe teknika bashkëkohore



Oda Stomatologjike e Maqedonisë me rastin e 20 vjetorit të themelimit të saj organizoi simpozium edukativ me temë “Metodat dhe teknikat bashkëkohore stomatologjike”...

Kryetari i Odës Stomatologjike të Maqedonisë, Vlladimir Popovski, tha se stomatologjia ka iniciuar standarde më të larta pune me qëllim të arritjes së profesionalizmit duke shtuar se për këtë nevojiten mjete shtesë, për krijimin e kushteve më të mira të

punës.

**“Stomatologët në Maqedoni sikur edhe çdo profesion e kërkojnë pozitën e tyre në tregun dhe menaxhmentin që e ofron shteti ynë. Por akoma kemi një prodhim të madh të kuadrove, do të thojnë një mbiprodhim të kuadrove, dhe për këto Oda e Stomatologëve do të angazhohet që ky numër të kontrollohet, sepse kjo krijon kushte të konkurrencës të padrejtë”** – deklaroi kryetari i Odës stomatologjike të Maqedonisë, Vlladimir Popovski.

Mjetet e mbledhura nga ky simpozium edukativ do të ndahen për qëllime humanitare, në Klinikën për Gjinekologji dhe Akusherëri në Shkup. (Vlora Latifi – Topojani, TVM2)



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



**PORTALB**  
dritare realiteti

## Simpozium për 20 vjetorin e themelimit të Odës Stomatologjike të Maqedonisë



Oda Stomatologjike e Maqedonisë me rastin e 20 vjetorit të themelimit të saj organizoi simpozium edukativ me temë “Metodat dhe teknikat bashkëkohore stomatologjike”, raporton Anadolu Agency (AA).

Kryetari i Odës Stomatologjike të Maqedonisë, Vlladimir Popovski, tha se në këtë simpozium përmbyllës edukativ janë ftuar ligjërues eminentë të asociacioneve, në të cilën përfshihen njohuritë dhe praktikat më të reja, dhe ato që do të mund të zbatohen në praktikën e përditshme për të qenë më konkurrues.

Ai më tej u shpreh se stomatologjia ka iniciuar standarde më të larta pune me qëllim të arritjes së profesionalizimit. “Pikërisht stomatologjia ka ngritur standardet duke vendosur standarde më të larta që janë të nevojshme për punën e mjekësisë, pra të ketë profesionalizëm dhe ordinanca të pajisura në mënyrë evropiane. Për këtë nevojiten mjete shtesë, ndaj edhe në përpiqemi që të krijojmë kushte të paktën që financiarisht të punojnë në mënyrë më komode”, tha Popovski, duke shtuar se Oda e Stomatologëve, apo vendi përballet me një mbiprodhim të kuadrove stomatologë.

“Stomatologët në Maqedoni sikur edhe çdo profesion e kërkojnë pozitën e tyre në tregun dhe menaxhmentin që e ofron shteti ynë. Por akoma kemi një prodhim të madh të kuadrove, do të thoja një mbiprodhim të kuadrove, dhe për këto Oda e Stomatologëve do të angazhohet që ky numër të kontrollohet, sepse kjo krijon kushte të konkurrencës të padrejtë”, tha kryetari i Odës stomatologjike të Maqedonisë, Vlladimir Popovski.

Mjetet e mbledhura nga ky simpozium edukativ do të ndahen për qëllime humanitare, edhe atë në Klinikën për Gjinekologji dhe Akusherë në Shkup.